

## ***ABSTRAKT***

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK, ME VËSHTRIM TË POSAÇËM NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, GJATË PERIUdhËS KOHORE 2015-2019

Kandidatja: Shqipe Salihu

Mentori: Prof. Dr. Haki Demolli

Dihet se trafiku publik është një veprimtari e rëndësishme e cila ka ndryshuar marrëdhëniet në mes të njerëzve, bënë afrimin e tyre, duke zvogëluar kështu dhe largësitë prej vendit në vend, duke iu mundësuar këmbimin e mallrave e të mirave të tjera materiale dhe kështu e bënë botën më unike. Zhvillimi i hovshëm i tij ka bërë që në të, të inkuadrohen gjithnjë e më shumë persona po ashtu edhe mjete të ndryshme motorike, andaj janë shtuar rreziqe për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Këto rreziqe përcjellen me aksidente të shumta, që në të shumtën e rasteve rezultojnë me dëme materiale në automjete, dëme materiale dhe jomateriale si pasojë e lëndimeve të ngasësve të automjeteve dhe personave të tretë (bashkëudhëtarëve) apo këmbësorëve, të shkaktuara në aksident dhe që poashtu nuk mungojnë as ato fatale, e që fatkeqësisht si numër është mjaft i madh.

Duke pasur parasysh këtë si dhe numrin e madh të kryerjes së veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik në vendin tonë, më ka shtyer drejtë studimit si dhe hulumtimit të këtyre veprave penale.

Qëllimi i punimit është studimi, respektivisht vëllimi dhe dinamika e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik, politika ndëshkimore në territorin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega Podujevë për periudhën kohore 2015-2019.

Gjatë hulumtimit dhe përpilimit të këtij punimi, janë përdorur këto metoda: metoda juridike-dogmatike, metoda e analizës teorike, metoda historike, metoda statistikore dhe metoda krahasimore.